

**KRONIKË PËR KONFERENCËN SHKENCORE ME TEMË:
POLEMIKAT LETRARE**

Departamenti i studimeve letrare, në kuadrin e Ditëve të Albanologjisë, në 22 dhjetor 2015 zhvilloi Konferencën shkencore me temë: *Polemikat letrare*. Duke i konsideruar polemikat, si pjesë e pandashme e mendimit shkencor mbi periudha të ndryshme të zhvillimit të letërsisë, studiuesit e Departamentit, u përqendruan në çështje të cilat kishin mjaft interes dhe krijonin një ide si mbi praninë e polemikave në mendimin shkencor të periudhave të ndryshme, ashtu dhe mbi çështje, trajtimi i të cilave krijonte polemikë me mendimin gjerësisht të shprehur.

Studiuesit mbajtën kumtesat e mëposhtme: **prof. dr. Laura Smaqi**: *“Këngët e Milosaos” si gjeneruese polemikash* **prof. dr. Shaban Sinani**: *Krisja e parë në “Brezin e viteve ‘60”*: rasti i novelës

“Dikush më buzëqeshte”, **prof. dr. Klara Kodra**: *Migjeni, ky shkrimtar kaq i diskutuar*, **prof. asoc. dr. E. Paci**: *Meshari i Gjon Buzukut, një çelës për leximin e teksteve biblike në gjuhën shqipe*, **prof. asoc. dr. G. Abazi**: *Procesi i kombformimit tek shqiptarët dhe letërsia e vjetër shqipe*: *Nezim Berati, Hasan Zyko Kamberi dhe poetët shkodranë të shek. XVIII.*, **dr. E. Tartari**: *Rreth tekstit të Konicës për gjuhët natyrore dhe ato artificiale*, **dr. V. Graçi** - *Polemistë të rinj bashkëkohorë - modele të tejkaluara polemikash.*

Në këtë konferencë u shfaqën ide e mendime mjaft interesante, të cilat dëshmuuan se çështja e polemikave letrare është e tillë që hap gjithmonë perspektiva të mundshme diskutimesh.

Laura SMAQI